



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 448 prot.

Tiranë, më 28. 03. 2023

V E N D I M

Nr. 47, datë 28. 03. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² shqyrtoi ankesën nr. 204 Regj., datë 20.12.2022³, të shtetases A. Gj., kundër Bashkisë Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se, ankuesja A. Gj., banuese në Tiranë, aktualisht është një person me aftësi të kufizuar, si pasojë e një aksidenti automobilistik që ka pësuar para disa kohësh.⁴ Pas kurimit, ankuesja sqaron se ka vështirësi në mbjaltjen e ekuilibrit, në dëgjim, artikulimin e mirë të fjalëve, si dhe me kujtesën. Ajo shprehet se çdo ditë lufton, mundohet dhe përpiqet për të fituar aftësi të plota, autonomi veprimi dhe të integrohet në shoqëri. A. Gj. sqaron se del çdo ditë nga banesa e saj, që ndodhet tek rruga e Qelqit në Tiranë, në zonën e Kombinatit dhe duke shfrytëzuar transportin publik ose duke ecur në këmbë me vështirësi, ajo shëtit tek Kodrat e Liqenit. Kjo rutinë është e përditëshme për të edhe kur moti është me shi apo temperaturat janë të ulëta.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Plotësuar ankesa më datë 04.01.2023.

⁴ Si pasojë e aksidentit, ankuesja ka rënë në koma dhe për një periudhë 8 mujore ka qenë e shtruar në një spital rehabilitimi në Romë, Itali.

Ankuesja sqaron se çdo ditë has problematika të shumta në trotuaret përgjatë rrugës së Qelqit, pasi hapësirat e tyre janë të zëna nga tregtarët dhe bizneset e tyre, që shesin jo vetëm brenda hapësirave të dyqaneve të tyre, por kanë zënë edhe hapësirën e kalimtarëve në trotuaret përkatëse. Ankuesja shprehet se e ka të vështirë të mbajë ekuilibrin dhe shpesh herë përplaset me njerëzit apo mallrat e vëna në rrugën e kalimtarëve. Për të shmangur sa më sipër, ajo thekson se kalon në rrugën e makinave, duke vënë në rrezik jetën e saj. Ankuesja ka depozituar në cilësi prove foto të trotuarëve të rrugës së Qelqit në Kombinat, ku rezulton se këto trotuare janë të zënë me mallra të ndryshëm nga ana e tregtarëve.

Për sa më sipër, A. Gj. pretendon se diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi është ky institucion dhe strukturat në varësi të saj, që duhet të kujdesen dhe të ndalojnë zënien pa leje të hapësirave publike⁵, si trotuaret dhe rrugët, nga ana e tregtarëve dhe bizneseve, në qytetin e Tiranës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

⁵Referuar nenit 8, pika 6, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” ku parashikohet: *“Policia e bashkisë dhe e komunës ka për detyrë:Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë apo komunës si dhe të organizojë lirimien e tyre.”*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 21 prot., datë 06.01.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën⁶ nr. 566/1 prot., datë 18.01.2023, Policia Bashkiake Tiranë ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj, lidhur me sa ka pretenduar subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se:

“Në Njësinë Administrative Nr. 6, rruga e “Qelqit” është objekt i kontrolleve të përditshme nga punonjësit e Policisë Bashkiake, për shkak të problematikës që paraqet, në lidhje me zënien e hapësirave publike (sheshe, trotuare, rrugë) nga individë (tregtarë ambulancë, qytetarë) apo subjekte. Lidhur me këtë problematikë, përgjatë vitit 2022, nga shërbimet e Policisë Bashkiake janë vendosur 1161 masa administrative me një vlerë totale prej 1.084.000 lekësh të reja.

Zona e lartpërmendur, si dhe i gjithë territori i Bashkisë Tiranë, do të vijojë të kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme dhe në rast konstatimi të kundravajtjeve administrative “zënia e hapësirës publike, pa lejen përkatëse nga Bashkia Tiranë”, do të merren masa sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, është marrë kontakt me ankuesen, A. Gj., e cila na komunikoi se rrugë kalimet në trotuar janë të lira dhe nuk ka problematikë në lëvizjen e saj”.

2. Përsa më sipër, me anë të e-mail-it datë 24.01.2023, Komisioneri iu drejtua subjektit ankues duke i vënë në dispozicion përgjigjen e Policisë Bashkiake Tiranë, si dhe duke i kërkuar informacion nëse problematika e ngritur në ankesë ka marrë zgjidhje.

Në përgjigje përsa më lart, ankuesja me anë të e-mail-it datë 27.01.2023, sqaroi se trotuari nuk është plotësisht i liruar dhe për këtë arsye nuk e konsideronte të zgjidhur çështjen.

3. Në vijim me anë të e-mail-it datë 07.02.2023, Komisioneri kërkoi nga ankuesja informacion nëse në dijeninë e saj, janë marrë masa nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë për lirimin e hapësirave publike, trotuarit, në segmentin rruga e Qelqit.

Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar, ankuesja sqaroi ndër të tjera se në segmentin rruga e Qelqit është ndërhyrë nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, për lirimin e hapësirave publike, por trotuari nuk është i liruar plotësisht.

4. Në mbështetje të neneve 45, 80-87 të Kodit të Proçedurave Administrative, nenit 32, pika 1, gërma a) dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1013 prot., datë 12.07.2022.

nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me Urdhërin nr. 33, datë 02.03.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, inspektorët e KMD-së u paraqitën në Rrugën e Qelqit, Kombinat, më datë 10.03.2023, për evidentimin e rrugë kalimeve në trotuar, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga A. Gj. Për këtë, Komisioneri njoftoi Policinë Bashkiake Tiranë, duke kërkuar prej tyre të jenë prezent gjatë kryerjes së inspektimit.

Sipas njoftimit të bërë, inspektorët e KMD-së më datë 10.03.2023 morën takim me përfaqësuesit e Policisë Bashkiake Tiranë, në Rrugën e Qelqit, në prani të të cilëve u zhvillua inspektimi. Gjatë inspektimit të kryer u realizuan fotografi dhe video gjatë segmentit rrugor të cilat u bënë pjesë të dosjes, si dhe u konstatua se trotuari dhe hapësirat publike për këmbësorët ishin të lira.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Policisë Bashkiake Tiranë, u sqarua se në segmentin Rruga e Qelqit, në vazhdimësi ushtrohej kontroll i përditshëm për lirim të hapësirave publike. Në rastet kur konstatohej zënia e tyre, ndaj subjekteve në shkelje marreshin masa administrative me gjobë. Gjithashtu, u theksua se përfaqësuesit e Policisë Bashkiake Tiranë kanë marrë takim në disa raste me A. Gj., për t’i dhënë zgjidhje problematikave me të cilat ajo mund të përballëj, duke i ofruar të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm që ajo apo çdo shtetas do të kishte, lidhur me zënien e hapësirave publike.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁷, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me lirin e hapësirave publike në segmentin Rruga e Qelqit.

⁷ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”

Bazuar në deklaratimet e provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe kronologjisë së ngjarjeve, rezultoi se:

Ankuesja A. Gj., është person me aftësi të kufizuara dhe banon në Rrugën e Qelqit, Tiranë. Si pasojë e një aksidenti automobilistik, ankuesja ka vështirësi në mbajtjen e ekuilibrit, në dëgjim, artikulumin e mirë të fjalëve, si dhe me kujtesën. Referuar pretendimeve të ankueses, ajo çdo ditë has problematika të shumta në trotualet përgjatë rrugës së Qelqit, pasi hapësirat e tyre janë të zëna nga tregëtarët dhe bizneset e tyre, që shesin jo vetëm brenda hapësirave të dyqaneve të tyre, por kanë zënë edhe hapësirën e kalimtarëve në trotualet përkatëse. Në këto kushte, ankuesja ka vështirësi për të aksesuar apo ecur pa pengesa përgjatë rrugës së Qelqit.

Misioni dhe përgjegjësitë e Policisë Bashkiake përcaktohen në nenin 1 të ligjit nr 8224 datë 15.05.1997 *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës”*, ku shprehet se: *“Policia Bashkiake dhe e Komunës është organ ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë apo komunës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore”*.

Ligji Nr. 8224, datë 15.5.1997 *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”*, në nenin 8, pika 6, parashikon se: *“Policia e bashkisë dhe e komunës ka për detyrë:.....Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë apo komunës si dhe të organizojë lirimimin e tyre.”*

Nga informacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, A. Gj. fillimisht vuri në dispozicion të Komisionerit disa fotografi të realizuara në Rrugën e Qelqit, në të cilat konstatoheshin që 2 (dy) subjekte private, kishin zënë një pjesë të vogël të trotuarit me produkte të cilat ata tregtonin.

Pas marrjes së ankesës, Komisioneri iu drejtua shkresërisht Bashkisë Tiranë, të cilët informuan nëpërmjet shkresës nr. 566/1 prot., datë 18.01.2023 të Policisë Bashkiake, se rruga e “Qelqit” është objekt i kontroleve të herë pas herë nga punonjësit e tyre, për shkak të problematikës që paraqet, në lidhje me zënien e hapësirave publike nga individë (tregtarë ambulant, qytetarë) apo subjekte. Gjithashtu, si subjekt përgjegjës për lirimimin e hapësirave publike, ata kishin marrë një numër prej 1161 masa administrative për këtë qëllim gjatë vitit 2022.

Nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë në përgjigjen e sipërcituar, por edhe gjatë inspektimit të kryer me përfaqësuesit e Komisionerit, informuan se kanë marrë kontakt me ankuesen, A. Gj., për t'i dhënë zgjidhje problematikave me të cilat ajo mund të përballëj në të ardhmen, duke i ofruar të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm që ajo apo çdo shtetas do të kishte lidhur me zënien e hapësirave publike.

Nga inspektimi i zhvilluar në trotualet përgjatë Rrugës së Qelqit, referuar edhe në provat e grumbulluara (fotografi dhe video të realizuara gjatë inspektimit), u konstatua se trotuari dhe

hapësirat publike për këmbësorët në këtë segment rrugor ishin të lira dhe nuk kishin pengesë për kalimin e lirë të tyre.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkisë Tiranë nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme kundrejt ankueses, përse ajo ka pretenduar. Nga analiza e akteve të sipërcituara dhe provave të administruara, Policia Bashkiake Tiranë, si subjekti përgjegjës dhe i ngarkuar me ligj për mbarëvajtjen e punëve publike dhe lirin e hapësirave publike, rezulton të ketë ushtruar herë pas here kontrole në Rrugën e Qelqit, gjatë së cilave ka vendosur edhe sanksione me gjobë kur ka konstatuar zënien e hapësirave publike.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1/2 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku;

b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore,

duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;

d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim;

dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;

e) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim;

ë) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim;

f) lehtësi për transport ose udhëtim;

g) shërbimet e profesioneve të lira.”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, kundrejt ankuses, për shkakun e pretenduar prej saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, A. Gj., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)